

# albinfo.ch

FLET LIDERSHIPI SHQIPTAR NË MAQEDONI

## TRYEZË

«SI TË FAKTORIZOHEN SHQIPTARËT NË MAQEDONI?»

SHKUP, 17 MARS 2016 - HOTEL BUSHI RESORT & SPA

Kjurchiska 21, SHKUP - ORA 15.00 - 17.00

Pesëmbëdhjetë vjet pas konfliktit të 2001-ës dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, shqiptarët në Maqedoni ende ballafaqohen me një sërë sfidash politike, socioekonomike dhe kulturore me peshë. Konturat e statusit të tyre politik kombëtar mbeten ende të padefinuara mirë, gjë që gjeneron cikle të vazhdueshme krizash në raport me shtetin e Maqedonisë si dhe tensione me popullatën maqedonase. Veç kësaj, indikatorët e zhvillimit të potencialit njerëzor të shqiptarëve në Maqedoni mbeten po ashtu shumë nën nivel në raport me popullatën maqedonase.

Duke u nisur nga nevoja e krijimit të një hapësire demokratike të të kuptuarit më mirë të situatës aktuale, Albinfo.ch, platformë mediale e diasporës shqiptare, e involvuar në zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve të Ballkanit, synon të realizojë një debat me lidhshpër politik shqiptar në Maqedoni, me qëllimin që të shqyrtohen rrugët se si të faktorizohen shqiptarët e Maqedonisë në vendimarrjet politike me peshë dhe që u siguron atyre statusin politik që meritojnë në raport me peshën e tyre demografike.

### PJESËMARRËS

- IZET MEXHITI** – NËNKRYETAR I BASHKIMIT DEMOKRATIK SHQIPTAR (BDI) e konfirmuar  
– PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE (PDSH)
- BEJTULLAH DEMIRI** - ANËTAR I KRYESISË QENDRORE LËVIZJA BESA e konfirmuar
- ZIJADIN SELA** – KRYETAR I LËVIZJES PËR REFORMA PDSH (LRPDSH) e konfirmuar
- MUHAMED ISMAILI** – SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I UNITETI-t e konfirmuar  
– RILINDJA DEMOKRATIKE KOMBËTARE (RDK)

### HYRJA NË DEBAT DHE MODERIMI

**Dr. BASHKIM ISENI** – DREJTOR I PLATFORMËS ALBINFO.CH

### KONTRIBUTE HYRËSE

- Dr. BEHLUL BEQAJ**, ANALIST POLITIK, PRISHTINË
- Dr. SADRI RAMABAJA** – STUDIES, ANËTAR I VV NË ASAMBLENË E PRISHTINËS
- NAIM RASHITI** –DREJTOR -BALKANS GROUP, INTERNATIONAL CRISIS GROUP
- NAZIM RASHIDI** –GAZETAR, PRODUKTOR

# albinfo.ch

Qëllimi i kësaj nisme është të ndikojë në ngritjen e nivelit të debatit politik, duke e parë dukurinë e fragmentimit të përfaqësimit politik shqiptar në Maqedoni si dhe tendencën e atribuimit fetar të çështjeve që janë të natyrës politike dhe kombëtare.

- Cilët janë faktorët kryesorë kauzalë që e shpjegojnë stagnimin si dhe regresin shoqëror, socio-ekonomik si dhe edukativo-kulturor në të cilin gjenden aktualisht shqiptarët në Maqedoni?
- Cilat janë konkretisht barrierat që e pengojnë realizimin politik dhe socio-ekonomik kolektiv të shqiptarëve në Maqedoni dhe si mund të tejkalohen ato? Sa përgjegjësia e kësaj gjendjeje bie mbi politikanët vendës shqiptarë?
- Sa demokracia funksionon te partitë shqiptare që i përfaqësojnë shqiptarët dhe në çfarë mase mund të ndryshojë raporti i forcave brenda këtyre formacioneve politike, për të krijuar hapësirë politike për ndryshime të lidërshiptit, me qëllim të evitimit të disidencave apo krijimit të vazhdueshëm të partive të reja politike, gjë që ndikon në dobësimin e pozicionit të tyre politik në vend;
- A mund të dalin politikanët shqiptarë nga tradita e legjitimitetit karizmatik dhe të krijojnë mekanizma transparentë dhe demokratikë brenda strukturave që synojnë përfaqësimin e denjë të shqiptarëve si dhe mbrojtjen e interesave të tyre?
- Sa strukturat e reja politike opozitare shqiptare mund të arrijnë të artikulojnë zërin e tyre në suaza të një platforme politike të përbashkët, ku qartazi do të diagnostikohen problemet, si dhe të definohen qëndrimet, por edhe programet respektive politike karshi strukturave shqiptare si dhe atyre maqedonase në pushtet?
- Si mund të forcohen kapacitetet e lidërshiptit shqiptar dhe si të stopohet fragmentimi i mëtejshëm i përfaqësimit shqiptar në Maqedoni, kur partitë politike shqiptare do të ofrojnë programe politike konkrete, jashtë retorikës kombëtare dhe në funksion të nevojave socioekonomike të popullatës shqiptare?